7	Sistem per monitorimin dhe menaxhimin e pajisjeve te rrjetit	Lot	1			
8	Pajisje, materiale dhe aksesore ndihmes per sistemin	Lot	1			
9	Mirëmbajtje e sistemit - 12 muaj	Komplet	1			
<b>Çmimi total (Mallrat)</b>						_____
<b>Çmimi Neto pa TVSH</b>						
<b>TVSH (%)</b>						
<b>Çmimi total me TVSH:</b>						
<b>Emri i përfaqësuesit të ofertuesit</b>						
<b>Nënshkrimi</b>						
<b>Vula</b>						
<b>Datë</b> _____						

### Shtojca 3.

[ Shtojcë për t'u paraqitur nga operatori ekonomik)

[Letër me kokë e Bankës / Kompanisë së Sigurimeve]

## FORMULARI I SIGURIMIT TË OFERTËS

Për: [Emri dhe adresa e autoritetit/entit kontraktor]

Në emër të: [Emri dhe adresa e ofertuesit të siguruar]

\* \* \*

Procedura e prokurimit [lloji i procedurës]

Përshkrim i shkurtër i kontratës: [objekti]

Publikimi (nëse zbatohet): Buletini i Njoftimeve Publike [Data] [Numri]/Nr. Referencës në faqen e APP-se

\* \* \*

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur,

Ne vërtetojmë se [emri i ofertuesit të siguruar] ka derdhur një depozitë pranë [emri dhe adresa e bankës] / është garantuar pranë [emri dhe adresa e kompanisë së sigurimit] me një vlerë prej [monedha dhe vlera, e shprehur në fjalë dhe shifra] si kusht për sigurimin e ofertës, dorëzuar nga operatori i lartpërmendur ekonomik.

Marrim përsipër të transferojmë në llogarinë e [emri i autoritetit/entit kontraktor] vlerën e siguruar, brenda 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve nga kërkesa juaj e thjeshtë dhe e parë me shkrim, pa kërkuar shpjegime, me kusht që kjo kërkesë të përmendë mospërbushjen e njërit nga kushtet e mëposhtme:

- Ofertuesi e ka tërhequr ose ka ndryshuar ofertën, pas afatit përfundimtar për paraqitjen e ofertave ose para afatit përfundimtar, nëse është përcaktuar kështu në dokumentat e tenderit;
- Ofertuesi ka refuzuar nënshkrimin e kontratës se prokurimit kur autoriteti/enti kontraktor e kërkon një gjë të tillë;
- Ofertuesi nuk ka paraqitur sigurimin e kontratës, ku oferta është shpallur fituese ose nuk ka plotësuar ndonjë kusht tjetër përpara nënshkrimit të kontratës së përcaktuar në dokumentat e tenderit.

Ky Sigurim është i vlefshëm për periudhën e specifikuar në [njoftimin e kontratës].

[Përfaqësuesi i bankës / kompanisë së sigurimit]



#### Shtojca 4.

(Shtojce për tu paraqitur nga Operatori Ekonomik, nëse është rasti)

#### Lista e Informacionit Konfidencial

(Shkruani informacionin që dëshironi të mbetet konfidencial )

Lloji, natyra e informacionit që duhet mbajtur konfidencial	Numri i faqeve dhe pikave në DST që dëshironi të mbeten konfidenciale	Arsyet e mbajtjes konfidencial të këtij informacioni	Afati i fundit për mbajtjen konfidencial të këtij informacioni

#### VËMENDJE

Çdo e dhënë që nuk është regjistruar si konfidenciale do të konsiderohet se për të është dhënë pëlqimi i mbajtësit të një informacioni të tillë dhe Autoriteti/Enti Kontraktor nuk do të jetë përgjegjës për nxjerrjen e këtij informacioni.

Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkreisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial: çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

#### Përfaqësuesi i Ofertuesit

#### Nënshkrimi

#### Vula

---

## Shtojca 5.

[ Shtojcë për t'u plotesuar nga Autoriteti/Enti Kontraktor ]

### FORMULARI I SPECIFIKIMEVE TEKNIKE

---

## 1. HYRJE

### 1.1. Përfituesi /Autoriteti Kontraktues

Operatori i Sistemit të Transmetimit

### 1.2. Historiku

Rrjeti aktual nga pikëpamje logjike, trafiku i të dhënave është e ndarë në katër rrjete të ndërlidhura me anë të Nyjes Kryesore të Telekomunikacionit në qender. Në çdo stacion të rrjetit janë instaluar switche industrial që kanë funksionin për të lejuar lidhjen e RTU në rrjet dhe për të siguruar elasticitetin përmes protokollit RSTP. Për të parandaluar berjen aktive të disa rrugeve njëkohsisht, është përdorur STP e cila detyron disa rruge të kalojnë në gjendje jo aktive (Bllokimi). Nëse toplogjia e rrjetit ndryshon si pasojë e një defekti, STP rikonfiguron topologjinë e rrjetit duke u mundësuar rrugeve jo-aktive të nevojshme për të arritur në stacion. Katër rrjetet janë të ndërlidhur nëpërmjet routerave redundant në Tiranë, njëri aktiv dhe tjetri backup, dhe të konfiguruar në mënyrë që të krijojnë një adresë virtuale IP të caktuar dinamike për njërin router ose routerin tjetër. E gjithë kjo është transparente për përdoruesit e rrjetit. Në brendësi të rrjetit të komunikimit janë të instaluar routerat (dy në konfigurim redundant) për lidhjen në mes të rrjetit të komunikimit dhe SCADA. Këto routerat janë instaluar në nënstacion kryesor në Tiranë. Lloji i Routerave (Switch Layer-3) është Cisco Catalyst 3750V2 24 10/100 + 2 SFP Standard Image. Këto pajisje kanë (secila) 24 Ethernet 10/100 porta dhe dy porta optike. Cisco Catalyst 3750 Series është në dispozicion me ose imazhin e IP Bazë apo imazhin e shërbimeve IP. Tipari i imazhit të IP Base përfshin cilësi të avancuar të shërbimit (QoS), norma-kufizimin, listat e kontrollit të qasjes (ACL), aftësitë: rutim statik, Routing Information Protocol (RIP) dhe EIGRP stub routing.

### 1.3. Situata Aktuale në Sektor

Rrjeti është ndërtuar bazuar në switche Web-Managed Layer 2 dhe secili backbone përfundon lidhjen në nënstacionin Tiranë në një switch Layer 2 që është e lidhur me secilin router (Layer 3 switch). Këto switche janë të tipit RS900 (RuggedCom) dhe modul Nebro (familja FOX multiplexer) dhe suportojnë protokollin RSTP (për të eliminuar lupa në rrjet) dhe Link Agregimi (për të përfitur nga dy lidhjet në mënyrë paralele në mënyrë që të sigurojë një sasi më të madhe të bandwidth). Switchet e përmendura më sipër janë të pajisura me 9 porta - RS900 dhe 4 porta - Nebro, me shpejtësi maksimale prej 100Mbps.

Për të përmbushur kërkesat dhe për të marrë të gjitha përfitimet e teknologjisë së komunikimit (pajisjet, protokollat dhe software), është vepruar që të ketë një arkitekturë të rrjetit me mënyra të dyfishta të komunikimit, kudo që të jetë e mundur, me një konfigurim unazë ose mesh siç tregohet në vijim Figura 1,




Figura 1 Arkitektura e Rrjetit të Komunikimit

Arkitektura ekzistuese e rrjetit është theksuar në tre nivelet hierarkike:

- Unazat backbone që konvergjon në nyjen e komunikimit, dhe të cilat janë të lidhura me stacionet OST;
- Unaza dytësore që janë të lidhura me një ose dy stacione të vendosura në një unazë backbone, të cilat lidhen me fibër optike ose me DPLC fazë-tokë me stacionet kryesore të lidhur në rrjetin e energjisë elektrike me dy ose më shumë linja;
- Antenat, të cilat janë të lidhura në një stacion të vendosur në një unazë të dytesore apo backbone.

Kjo arkitekturë është bazuar në protokolle që operojnë në Layer 2. Komunikimi arrihet duke bërë span VLAN-et e nevojshme në gjithë rrjetin. Kjo mënyrë lidhje shpesh herë sjell probleme në komunikim si pasoje e loop-ave që ndodhin në këto rrjet që shtrihet në të gjitha pikat e OST. Ka vështirësi në zgjidhjen e problemeve sepse në rastet që kemi loop nuk mund të aksesohen as vetë pajisjet e rrjetit për të marrë masa për zgjidhjen e problemit.

Aktualisht ka mundësi fleksibiliteti në konfigurim për span VLAN-et konfigurimet e trunkeve tek cdo një hap pas hapi, kompleksiteti i algoritmit STP etj.

Pajisjet kryesore janë në fund të jetës së tyre nuk ofrohet suport me nga prodhuesit ose mirembajtja e tyre rrit kërkesën për shpenzime me të mëdha.

## 2. OBJEKTIVAT, QËLLIMI DHE REZULTATET E PRITURA

### 2.1. Objektivi i Përgjithshëm

Objektivi kryesor i projektit është zgjerimi dhe krijimi i një rrjeti redundancë me shumë rrugë komunikimi, cka do të mundësojë sistemit SCADA në OST komunikim fleksibel të sigurtë të nyjeve periferike (RTU dhe LCS) të instaluar në sistemin energjetik të Shqipërisë.

### 2.2. Qëllimi

---

Qëllimi i kësaj kontrate është si më poshtë:

Qëllimi i punës përfshin projektimin, ndërtimin, zhvillimin, vënien në punë, komisionimin dhe testimin e lidhjeve dhe komunikimit në çdo nyje, me qëllim menaxhimin dhe monitorimin në kohë reale të komponenteve aktive të marrjes së të dhënave.

### **2.3. Rezultatet që Duhet të Arrihen nga Kontraktor**

Kontraktori duhet të bëjë projektin inxhinierik të detajuar, ta zbatojë dhe ta realizojë duke respektuar të gjitha standardet përkatëse të sistemeve, rrjeteve të komunikimit, standardet ENTSO-E dhe praktikën dhe eksperiencat me të mira të sistemeve energjitike evropiane.

Projekti duhet të konsiderohet “Turn Key”, pra me çelës në dorë. Rezultatet që priten të arrihen nga kontraktori për këtë projekt janë:

- Projektimi i rrjetit të komunikimit bazuar mbi infrastrukturën ekzistuese të telekomunikacionit të OST.
- Projektimi i rrjetit duke pasur parasysh mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
- Përdorimi i pajisjeve ekzistuese të telekomunikacionit në nivel transporti
- Krijimi i rrjetit me arkitekture që të garantojë redundancë të plote të komunikimit.
- Rrjeti të bazohet mbi protokollin TCP/IP me ndërfaqe Ethernet.
- Përdorimi i protokolleve të komunikimit standarde dhe të besueshme.
- Të mundësojë menaxhimin dhe aksesin në çdo element të rrjetit nga distanca “Remote Connection”.
- Të realizojë transmetimin “bidirectional” të dhenave midis RTU dhe Qendres së Menaxhimit SCADA, përmes dy lidhjeve alternative logjike, me “automatic switch-over” në rast të bllokimit apo të ndonjë defekti në linkun operativ;
- Të realizojë lidhje me LAN-in e OST me anë të firewall në mënyrë që të kontrollohen akseset nga jashtë rrjetit të komunikimit të matjes së energjisë.

## **3. SUPOZIMET DHE RISQET**

---

### **3.1. Supozimet e Projektit**

- Supozohet që kontraktori duhet të jetë i informuar për vendodhjen e nënstacioneve ku do të kryhet implementimi i projektit si dhe të ketë parashikuar të gjitha shpenzimet operacionale për të përbushur procesin e levrimit pa kosto shtesë për autoritetin kontraktor.
- Supozohet që kontraktori në zgjidhjen e vet teknike të konsiderojë çdo material element pasiv apo aktiv si pjesë e implementimit të projektit.

### **3.2. Rrisqet**

Risku i procesit - është dështimi i proceseve ose sistemeve për shkak të konceptimit të gabuar të tyre, kompleksitetit ose mos-performimit të sistemit. Këtu mund të përmendim ndryshime domethënëse të situatës në funksionimin e rrjetit aktual i cili mundet të cenohet gjatë procesit të ndërtimit të infrastruktures së re IP

Kjo kategori rrisqesh përfshin mangësitë teknike të personelit, skedulet jo korrekte të implementimit të programeve të ndryshme gjatë konfigurimit, respektimin e buxheteve të alokuara, zhvillimin e funksioneve të gabuara në program, ndërfaqen e gabuar nga përdoruesit etj. Këtu përfshihet dhe zëvendësimi i shpejtë i teknologjisë aktuale mund të sjellë kosto të larta operacionale gjatë implementimit të projektit. Vështirësia në aksesimin e stacioneve të largëta (kushtet e sistemit rrugor, periudha kohore (në dimër rritet risku i bllokimit nga kushtet atmosferike); etj.

## 4. QËLLIMI I PUNËS

### 4.1. Të Përgjithshme

#### 4.1.1. Përshkrimi i detyrës

Ne realizimin e rrjetit të komunikimit Kontraktuesi duhet të përdorë teknologjinë me të përparuar në dispozicion në aspektin e dizajnit dhe të projektimit dhe duhet të ofrojë fleksibilitet maksimal për të mundur mundësitë në të ardhmen zgjerimin dhe përmirësimin e sistemit në fjalë (nyje të reja të komunikimit) duke pasur parasysh dinamikën dhe zhvillimin e parashikuar në vitet e ardhshme për sistemin energjetik në Shqipëri.

Pas vënies në punë të rrjetit të komunikimit me kusht, shtesat dhe përditësimet e nevojshme për të përmbushur kërkesat e reja operative duhet të bëhen të mundur përmes ndryshimeve të vogla apo me shtimin e moduleve lehtësisht të disponueshme në treg.

Kontraktuesi do të ketë detyrë të bëjë:

- Përshtatjen dhe lidhjen e rrjetit ekzistues me ndërfaqet e ROUTER /SWTCH /EMS në kordinim me mirembajtjesin e sistemit SCADA në OST.
- Hartimin e një plani për ndërhyrjen në rrjetin ekzistues dhe në pajisjet aktive ekzistuese të OST, i cili do të paraqitet për aprovim nga OST. Kjo është e nevojshme për të shmangur çdo anomali dhe problem në funksionet e ekzistues nga ndërhyrja në rrjet.
- Planin e konfigurimit të rrjetit TCP / IP.
- Implementimin e planit të miratuar nga personat e autorizuar në OST.

Kontraktori duhet të bëjë projektin teknik dhe çdo dokumentacion teknik dhe ta paraqesë në OST për miratim. Gjithashtu duhet të paraqitet për miratim në OST çdo pajisje që do të instalohet apo punim që do të bëhet në kuadër të projektit.

#### 4.1.2. Hapësira gjeografike që do të mbulohet

Sistemi mbulon të gjithë territorin e Shqipërisë në stacionet si më poshtë :

1	BABICE	11	KUÇOVE
2	BISTRICE / GJIROKASTER	12	LAÇ 1
3	BURREL	13	MEMALIAJ
4	ELBASAN 1	14	PESHKOPI
5	ELBASAN 2	15	PRRENJAS
6	FIER	16	RRASHBULL
7	FIERZE	17	TIRANA 2
8	FUSHE ARREZ	18	VAU DEJES
9	KOMAN	19	ZEMBLAK
10	KOPLIK		

#### 4.1.3. Siguria e sistemit

Hyrja e fizike e kontraktorit në qendrat e të dhënave, salla e të dhënave, dhe hapësira e dhomës së rrjetit do të jetë e kufizuar për ata me nevojë operacionale për të hyrë në ato hapësira dhe do kryhet e shoqëruar. Autorizimi u sigurohet personave që kanë nevojë për qasje në zonat e përcaktuara, bazuar në profilin e tyre të punës dhe që kanë marrë një kartë personale të hyrjes. Mjetet e aksesit fizik (p.sh. çelësat, kartat e hyrjes, kodet e hyrjes) do të shpërndahen në një mënyrë të kontrolluar në mënyrë që në çdo moment të kohës, të mund të merret një listë e plotë e individëve të emëruar që kanë qasje fizike. Aksesit në sistemet më kritike bazuar në vlerësimin e rritjes do të jepet përkohësisht vetëm nëse natyra e nevojës së biznesit për një person është gjithashtu e përkohshme (p.sh. për punën e

lidhur me projektin). Proceset e punës për të përcaktuar natyrën e hyrjes së kërkuar do të vendosen në përputhje me të gjitha departamentet e përfshira. Secili nga tre llojet e mëposhtme të ID badges duhet të dallohet qartë nga njëri-tjetri: Kontraktor, Vizitor, etj.

Disponueshmëria	Integriteti	Konfidencialiteti	Niveli i Sigurisë
<input checked="" type="checkbox"/> D3	<input checked="" type="checkbox"/> I3		<input checked="" type="checkbox"/> L

Niveli i sigurisë është i lartë (L), nëse disponueshmëria e të dhënave është D3 ose integriteti i të dhënave është I3.

Kjo procedure i referohet pikës A 11 të sistemit të menaxhimit të sigurisë së informacionit ISO 27001:2013

#### 4.2. Detyrat specifike

Rrjeti komunikimit duhet të sigurojë disponueshmërinë e kanaleve të nevojshme për transmetimin e të dhënave për të mbështetur aktivitetet dhe kontrollin, me një nivel të mirë të besueshmërisë. Kontraktori duhet të kryejë një vëzhgim në çdo site “site survey”, në mënyrë që të njohë dhe të evidentojë pajisjet dhe mënyrën e ndërtimit të rrjetit.

Detyrat specifike të kontraktorit për realizimin e projektit të rrjetit të komunikimit duhet të fokusohen në realizimin e këtyre pikave:

- Gjithë lidhjet duhet të jenë bazuar në infrastrukturen aktuale me fiber optike dhe pajisjet aktive ekzistuese me PLC/SDH/OTN.
- Deshtimi i një komponenti të vetëm ose mungesa e një lidhjeje nuk duhet të çojë funksionimin e rrjetit në teresi ose të asaj pjesë të rrjetit.
- Tranqet e ndryshme të rrjetit duhet të përbejnë një rrjet elastik në të cilin të dhënat do të rrugëzohen automatikisht në prani të ndonjë bllokimi të trafikut ose të ndonjë defekti.
- Rrjeti duhet të jetë redundant në konfiguracion “ring, mesh”.
- Projektimin e rrjetit duhet të sigurojë mundësinë e zgjerimit të tij në të ardhmen.
- Rrjeti duhet të bazohet mbi protokollin TCP/IP me ndërfaqe Ethernet.
- Të përdoren protokolle komunikimi të përparuar.
- Menaxhim dhe akses në çdo element të rrjetit nga distanca “Remote Connection”.
- Kapaciteti minimal i lidhjes në pikat fundore (ku nuk është i mundur kapaciteti më i lartë për arsye teknike objektive) duhet të jetë 20 Mbps.
- Kapaciteti i tranqeve kryesore duhet të jetë  $\geq 100$  Mbps.

Të gjitha komutimet (“switching”), nga rruga kryesore në ato redundante duhet të bëhen në mënyrë automatike në një kohë të pa ndikueshme në komunikim. Rrjeti duhet të jetë transparent. Autoriteti kontraktor do të mbështetë kontraktorin për të kryer Do të upgrade të pajisjeve përkatëse të telekomunikacionit me module shtesë si dhe rikonfigurim i pajisjeve ekzistuese me qëllim krijimin e rrugëve të pavarura të komunikimit. Me qëllim që të sigurohet një komunikim dhe marrje e të dhënave në mënyrë të sigurt është i nevojshëm krijimi i sistemit bazuar në konfigurim redundant që në marrjen e sinjalit dhe në transmetimin e tij në rrugë të pavarura deri në SCADA FW.

Modulët shtesë do të jenë në përputhje me karakteristikat e pajisjeve ku do të instalohen si dhe me funksionet e nevojshme për transmetimin e të dhënave nga nënstationet përkatëse drejt QME.

Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe modulët shtesë për upgrade të telekomunikacionit të nevojshme për sistemin (si në nënstatione ashtu dhe në QME) edhe pse nuk janë të përmendura në mënyrë specifike në dokumentacionin e projektit.

#### Testimi dhe dokumentacioni përfundimtar

Në përfundim të projektit do të kryhet testimi final i të gjithë sistemit. Kontraktori duhet të parashikojë të gjitha pajisjet dhe aparatet testuese të nevojshme dhe të gjitha testimet do të jenë në ngarkim të tij.

---

Kontraktori ne perfundim te projektit duhet te dorezoje te gjithe dokumentacionin perfundimtar, "AS BUILT", ne te cilin duhet te jene:

- Projekti i zbatimit (perfundimtar)
- Specifikimet e pajisjeve
- Konfigurimet perfundimtare te pajisjeve
- Çertifikatat e pajisjeve
- Lista e pajisjeve dhe materialeve te furnizuara

## 5. LOGJISTIKA DHE KOHA

---

### 5.1. Vendndodhja

1	BABICE	11	KUÇOVE
2	BISTRICE / GJIROKASTER	12	LAÇ 1
3	BURREL	13	MEMALIAJ
4	ELBASAN 1	14	PESHKOPI
5	ELBASAN 2	15	PRRENJAS
6	FIER	16	RRASHBULL
7	FIERZE	17	TIRANA 2
8	FUSHE ARREZ	18	VAU DEJES
9	KOMAN	19	ZEMBLAK
10	KOPLIK		

### 5.2. Data e Fillimit dhe Periudha e Implementimit të Detyrave

Data e destinuar e fillimit është data e nënshkrimit të kontratës ose data e përcaktuar në kontratë dhe periudha e zbatimit të kontratës do të jetë (4) kater muaj nisur nga kjo datë dhe 1 vit mirëmbajtje.

## 6. RAPORTIMI

---

### 6.1. Kërkesat e Raportimin

Kontraktuesi do të paraqesë raportet e mëposhtme në gjuhën shqipe në origjinal dhe tre kopje:

- **Raporti Fillestar** prej maksimumi tre faqesh duhet të prodhohet brenda tre (3) jave, nga fillimi i implementimit. Në raport Kontraktuesi duhet të përshkruaj gjetjet fillestare, progresi në mbledhjen e të dhënave, çdo vështirësi të pritura ose të hasura përveç programit të punës apo udhëtimeve të stafit. Kontraktuesi duhet të vazhdojë me punën e tij derisa Autoriteti Kontraktues të dërgoj komente mbi raportin fillestar
- **Drafti i raportit përfundimtar** duhet të perbehet prej maksimumi 10 faqesh. Ky raport duhet të dorëzohet jo më vonë se dy (2) jave para përfundimit të periudhës së zbatimit të detyrave.
- **Raporti final** me të njejtat specifika si drafti i raportit përfundimtar, me përfshirje në komenteve të pranura nga palët në draft raport. Afati i fundit për dërgimin e raportit përfundimtar është 10 ditë pas marrjes së komenteve në draft raportin përfundimtar. Raporti duhet të përmbajë një përshkrim mjaftueshëm të detajuar të opsioneve të ndryshme. Analizat e detajuara që i mbështesin rekomandimet do të prezantohen në anekset në raportin kryesor. Raporti përfundimtar duhet të sigurohet së bashku me faturën përkatëse.

Informacion tjetër i rëndësishëm për raportet.

- 1- Raport instalimi.
- 2- Raport i arkitekturës HW, SW i sistemit.
- 3- Inventari (HW, SW, etj.

---

## 6.2. Dorëzimi dhe Miratimi i Raporteve

Raporti i përmendur më sipër duhet t'i dorëzohet Menaxherit të Projektit të identifikuar si ndjekës i kontrates. Menaxheri i Projektit është përgjegjës për aprovimin e raporteve.

## 7. KOMUNIKIMI ME SISTEME TË TJERA

---

Sistemi është i mbyllur dhe nuk do jete e mundur te ekspozoje te dhenat ne ndonje sistem tjetër

## 8. GARANCIA

---

Periudha e garancise te sistemit qe do te implemetohet do te jete 12 muaj.

## 9. MIRËMBAJTJA

---

Marrëveshja e shërbimit të mirëmbajtjes së sistemit do të jetë për një periudhë një (1) vjecare në përputhje me dispozitat e VKM-së Nr. 710, datë 21 gusht 2013, "Për Krijimin dhe Funksionimin e Sistemeve të Ruajtjes së Informacionit, Vazhdueshmërisë së Punës dhe Marrëveshjeve të Nivelit të Shërbimit".

### Shërbimet e Mirëmbajtjes

Kompania duhet të ofrojë shërbime të mirëmbajtjes sipas kërkesës së përshkruar më poshtë:

- Shërbime të mirëmbajtjes parandaluese. Operatori ekonomik duhet të ndërmarrë, në mënyrë periodike një herë në muaj, Shërbime të Mirëmbajtjes Parandaluese për të gjitha software-et dhe hardware-et. Shërbimet Parandaluese, janë shërbime proaktive të cilat do të mundësojnë detektimin në kohë të problematikave, dhe do mundësojnë ndërmarrjen në kohë të hapave rekuperuese, për të mos patur ndërprerje të shërbimit.
- Shërbime Riparimi në vendndodhje (mjediset e autoritetit kontraktor/perfituesit) Operatori ekonomik duhet të jetë e disponueshme gjatë intervalit kohor, nga e Hëna në të Premte, 8x5, për të ofruar Shërbime të Riparimit në përgjigje të "Alarmeve Madhore" të raportuara nga personeli i autorizuar ("Emergency On-Call Hours"). Për këtë qëllim, me termin Alarm Madhor do të kuptohet parashtrimi i kërkesës për Shërbime Riparimi të ndërmarra në rast të keqfunksionimit të softwareve apo hardware të mbuluara, që i pengon ato të operojnë në përputhje me specifikimet dhe shkaktojnë ndërprerje të sistemit.
  - (i) Njoftimi dhe Njohja e Alarmeve Madhore. Personat përgjegjës do të njoftojë operatorin ekonomik me telefon, postë elektronike ose duke sinjalizuar nëpërmjet ndonjë ndërfaqeje web të vënë në dispozicion, dhe do të presë të kontaktohet nga operatori ekonomik me telefon, gjatë "Emergency On-Call Hours". Operatori ekonomik duhet të kontaktojë personelin përgjegjës dhe të konfirmojnë marrjen e Alarmit Madhor brenda 30 minutave nga marrja e njoftimit nga personeli i autorizuar.
  - (ii) Përgjigja ndaj Alarmeve Madhore. Nëse operatori ekonomik nuk mund të përcaktojë shkakun e defektit nga komunikimi me personelin e autorizuar, atëherë ai duhet të dërgojë një Teknik Shërbimi pranë Zyrave Qendrore te Autoritetit Kontraktor/Perfituesit brenda intervalit kohor prej (4) kater orësh nga momenti i marrjes së njoftimit për Alarm Madhor. Me të mbërritur, tekniku i kompanisë do të mbështetet me asistencë nga personeli i autorizuar dhe do t'i jepet liri veprimi në mjediset dhe sistemet e mbuluara, i shoqëruar dhe survejuar nga personeli i autorizuar, për të filluar menjëherë procedurat e diagnostikimit dhe riparimit.

Operatori ekonomik fitues duhet të dokumentojë çdo veprim, duke paraqitur gjendjen para dhe pas ndërhyrjeve si dhe duhet të marrë aprovimin paraprak për çdo ndërhyrje.

Palët e përfshira duhet të krijojnë një axhendë periodike kontrollesh (te cilat kur është e mundur mund te kryhen dhe remotely). Kontrollet jane si më poshtë:



- **1 (Nje) Mujore**
  - a. Kontroll i logeve të pajisjeve fizike.
  - b. Kontroll i statistikave për sistemin.
  - c. Kontroll i pajisjeve për probleme.
  - d. Të kryejë mirëmbajtje proaktive (mirembajtje parandaluese dhe parashikuese për makinat dhe pajisjet.
  - e. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.
  
- **3 (Tre) Mujore.**
  - a. Testim/kontroll i kompletuar i pjesëve më kritike të infrastrukturës së klientit.
  - b. Kontroll i detajuar i log-eve hardware/software.
  - c. Rekomandime për upgrade të mundshme hardware.
  - d. Kontroll i funksionaliteteve të sistemit.

## 10. AFATI KOHOR I IMPLEMENTIMIT TË PROJEKTIT

Grafiku i levrimin të shërbimit mbas lidhjes së kontratës me Autoritetin kontraktor

Nr.	Emërtimi i fazës / Periudha kohore	M1	M2	M3	M4	M5 – M16
1	Faza përgatitore	X				
2	Lëvrimi i pajisjeve hardware	X	X	X	X	
3	Faza e instalimeve dhe konfigurimeve		X	X	X	
4	Faza e testimit				X	
5	Trajnimi i përdoruesve				X	
6	Marrja në dorëzim				X	
7	Garancia/mirembajtja					X

## 11. KËRKESAT TEKNIKE DHE FUNKSIONALE

### Funksionalitete dhe Blokskema

Arkitektura e re që do të propozohet duhet të sigurojë një strukturë të aftë për të ofruar shërbimin me cilësi të lartë në një kontekst të besueshëm, ku dështimi apo mungesa e një elementi të vetëm nuk do të shkaktojë ndonjë ndërprerje të komunikimit. Kontraktori ka përgjegjësinë e plotë për planifikimin e procesit të handover të shërbimit, nga infrastruktura egzistuese në atë të re, duke garantuar mbajtjen e komunikimit të dhenave në punë.

### Topologjia e kërkuar, Star dhe partial mesh

Topologjia e re duhet të përfshijë lidhjen në Star për gjashtë pikat kryesore ekzistuese, që të jenë të pajisura me switche në stack dhe tre lidhje të ndryshme fizike me qendrën. Pjesa tjetër e nyjave do të lidhet në partial mesh me këto pika, por duhet të suportojë edhe mundësinë për lidhje të tjera shtesë me pikat kryesore ose me qendrën që do të shtohen në të ardhmen mbi rrjetin e ri optik OTN. Të gjitha linket që do të lidhen nyjat duhet të jenë në ndërfaqe Layer 3 dhe komunikimi duhet të jetë i bazuar mbi rutim. Duhet të eliminohet përhapja e VLAN-eve (Spanning) dhe Broadcast Domain midis

nyjave duke hequr nevojën e përdorimit të protokolleve Layer 2 për eliminimin e loop-ave (STP dhe variantet e tjera) pra duhet ndërtuar një rrjet redundant dhe loop-free.

Komunikimi duhet të mbështetet mbi algoritmin OSPF nga ku do të ngrihen si overlay MPLS dhe MP-BGP.




Figura 2 Topologjia e rrjetit Star - partial mesh

### Protokollet e rutimit dhe MPLS VPN

---

Nevojiten protokolle dinamike rutimi midis nyjave për rrugëzim automatik ne rast failure te një nyje/linje/porte te veçante, rrugëzim i ri dhe konvergjenca e kërkuar te jete automatike dhe për një kohe te shkurtër pa ndikuar ne cilësinë e shërbimeve.

Rrjeti do te mbështet mbi BGP/MPLS VPN qe bene te mundur segmentimin ne Layer 3 dhe ndarje te shërbimeve përgjatë gjithë rrjetit duke ofruar:

- Ndërlidhje VPN qe përhapen përgjatë gjithë rrjetit sipas nevojave
- Privatësi, trafiku i një VPN nuk shihet nga VPN e tjera (routing table te ndryshme brenda te njëjtës nyje)
- Adresim IP i pavaruar për secilën nga VPN (lejon te kemi IP overlapping, te përdoren IP njëjta ne VPN te ndryshme)
- Lehtësi zgjerimi/shkallzueshmeri sipas nevojave




Figura 3 Paraqitja skematike e një switchi për instanca të ndryshme rutimi

### **Adresimi IP**

Adresimi i nyjave te reja te rutimit nga pika ne pike midis pajisjeve te rrjetit dhe subnetet fundore te përdorura ne nënstacione dhe sensor.

Ndarja e uplinkeve fizike dhe trafikut te interesuar ne tabela te ndryshme rutimi duke përdorur instanca dhe tabela rutimi te ndara.

### **Nyja ne qendër dhe BackBone**

Nyja e komunikimit do te përbehet nga Switche me suport për MPLS dhe MP-BGP dhe tabela rutimi te mjaftueshme për te plotësuar nevojat e këtij projekti.

Ne qendër dhe ne 6 pikat e rëndësisë se veçantë nevojitet qe këto pajisje te jene te dubluar ne aspektet hardware dhe software ne mënyre qe te balancohet ngarkesa, te sigurohet redundanca e plote e komunikimit dhe mbrojtje ne rast dështimi te komponenteve fizik.

### **Nyjat kryesore**

Nyjat kryesore do te jene gjashte. Secila nga këto nyje duhet te jete e ndërtuar me switche ne stack qe funksionojnë si një nyje e vetme logjike dhe qe ofron redundance te plote ne rast dështimi te njëres prej pajisjeve.




Figura 4 OSPF BackBone dhe kufiri me Area 1 dhe Area 2

Këto gjashte nyje se bashku me nyjen qendrore do të formojnë Backbone për rrjetin dhe do të jenë të lidhura si star me tre linke të ndryshme drejt qendrës.

#### Nyjat dytësore

Këto nyje do të jenë të lidhura të paktën me dy nyje të ndryshme kryesore që do të shërbejnë si uplinke për të ardhur në qendër. Në këto nyja do të agregohet trafiku që vjen nga nën-stacionet dhe sensorët e ndryshëm lokal. Këto nyje do të marrin pjesë në domain MPLS dhe do të funksionojnë si PE/CE. Me anë të MPLS Layer 3 VPN do të bëhet ndarja e nyjeve fundore në VPN të ndryshme që do të rutohen në instanca të ndryshme rutimi neper pajisje drejt qendrës.




Figura 5 Area 2 e thjeshtuar dhe paraqitja e MPLS L3 VPN

### Antenat

Antenat janë stacionet, të cilat do të jenë të lidhura me një stacion të përfshirë në një kryesore apo dytësore, me lidhje radiale por kontraktori duhet të parashikojë që pathi back up të jetë i konfiguruar i gatshëm për tu përdorur.

### Nënstacionet

Në këto nënstacione duhet të bëhet upgrade i kapaciteteve hardware (moduleve) dhe rikonfigurimet përkatëse në software.

### Monitorimi i pajisjeve të rrjetit

Sistemi i implementuar, i integruar me rrjetin ekzistues ka nevojë për një sistem monitorimi dhe manaxhimi. Ky monitorim duhet të jetë në kohë reale por të mbajë dhe historikun për të gjeneruar raporte sipas nevojave.

## 12.SPECIFIKIMET TEKNIKE TË PAJISJEVE TË KËRKUARA

Meqë projekti konsiston në përmirësimet e një sistemi ekzistues që është në operim, specifikimet teknike të sistemit ekzistues do t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik fitues që do të implementojë përmirësimet e sistemit ekzistues.

### Switch në qendër (2 cope)

Switch Multi Layer - janë pajisje që do të shërbejnë për agregimin e gjithë trafikut dhe rrugëzimin e informacionit nga nënstacionet drejt qendrës. Për të siguruar redundance dhe back up të komunikimit switchet duhet të jenë të stakuar me njëri tjetrin në mënyrë që të mundësohet redundanca dhe kalimi automatik dhe funksional nga njëri switch tek tjetri në rast bllokimi ose defekti të njërit prej tyre. Switchet duhet të formojnë një stack llogjik me numër total portash prej minimumi 32 porta RJ45 dhe 16 porta SFP të shpërndara në mënyrë të barabartë për pajisjet. Tek ky stack do të terminohen tre uplinke të ndryshme (një ose dy linke SDH me RJ45 dhe një link DWDM me transceiver SFP) që vijnë nga secili stack i njërës kryesore në mënyrë që secila nga nyjet të jetë e lidhur me secilen nga pajisjet që formojnë stakun në qendër. Staku duhet të ketë në dispozicion edhe porta SFP+ 10Gb për lidhje me pajisjet e tjera në OST.

<b>Core Switch</b>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, aksesoret e përfshire;
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimumi 16 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• Minimumi 8 porta/slote SFP (100/1000BASE-X);</li> <li>• 4 porta 10Gb qe suportojne transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• Te paktën 8 porta me support për MACsec;</li> <li>• 1 porte menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 porte USB 2.0;</li> <li>• 1 porte Console (RJ-45 ose USB);</li> <li>• 1 slot i lire për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps (moduli nuk kërkohet te jete i përfshirë);</li> <li>• Kablla stakimi te përfshire;</li> </ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 512 MB flash;</li> <li>• 2 GB SDRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 4 MB;</li> </ul>
<b>Throughput/Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura non-blocking, te ofroj switchim wire-speed;</li> <li>• 180 Mpps throughput;</li> <li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 280 Gbps;</li> <li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li> <li>• Tabela e adresave MAC: 64K;</li> <li>• Vonesa (latency) me e vogël se 5 µs (porta 1 ose 10 Gbps);</li> <li>• Lista kontroll aksesi: ACL hyrëse(ingress) minimumi 2K;</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësire për 2 blloqe ushqimi;</li> <li>• Te jete i pajisur me dy blloqe ushqimi AC;</li> </ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri ne tete pajise ne një stack duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme qe lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• Teknologji e avancuar për ndërlidhjen për standarded OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te suportoj standardin IEEE 802.1Q, minimumi 1000 VLAN ID dhe standardin IEEE 802.1ad QinQ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE qe lejon grupimin dhe shfrytëzimin me te mire te linjave për te rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me ane te protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> <li>• Support per Jumbo frame 10 000 byte;</li> </ul>

<b>Karakteristikat e shtresës L3</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire(media);</li> <li>• Suport për rutim ne IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim ne IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Te ofroje ndërfaqe te adresueshme Loopback;</li> <li>• Standartet për tunelim te IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim ne Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM; si dhe te ofroje mundësi për menaxhim te adresave multicast dhe frenim te sulmeve DoS;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP te duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelim GRE per VPN qe mundëson tunelim te Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<b>Karakteristika te avancuara për rrjetin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te ofroje MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS);</li> <li>• Te ofroj VxLAN dhe EVPN;</li> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll me te mire ne shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) qe suportojne filtrime trafiku duke u bazuar ne informacionet nga shtresa L2 deri ne L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, ne VLAN dhe ne porte;</li> <li>• ACL ne hardware me TCAM;</li> <li>• Menaxhim me SSH, HTTP (TLS), SNMPv3 dhe me server qendror te tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Te ofroje mbrojtje nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<b>QoS</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Te suportoj funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Te suportojte standartet: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Te ofroje limitim te trafikut te tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast te panjohur;</li> </ul>
<b>Menaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim ne distance ne CLI me SSH, VLAN menaxhimi, Web UI, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për te pasur 2 imazhe te sistemit te operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan ne disa versione filet e konfigurimit qe lejon kthimin e pajisjes ne një gjendje te caktuara;</li> <li>• Port mirroring e aftësi për te përzgjedhur ne baze ACL trafikon hyrës/dalës nga një porte ose nje VLAN dhe te pasqyroje atë ne një porte lokale ose ne remote;</li> <li>• SNMP v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>

<b>Licensimi</b>	Pajisja Switch do te jete e licencuar për te gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius Lagështira relative e operimit: 10% to 95%, pa kondensim
<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim te pajisjes ne ditën vijuese te punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit te përfshira

### Switch ne nyjat kryesore (6x2 cope)

Këto pajisje do te konfigurohen ne stack dhe do te jene pjese e nyjave kryesore qe do te formojnë BackBone. Këto nyja do te mbledhin te gjithë trafikun rajonal.

<b>Switch Multi Layer</b>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, thellësia jo me shume se 40 cm, aksesoret e përfshire.
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimumi 24 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• 4 porta 10Gb qe suportojne transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• Te paktën 8 porta me support për MACsec;</li> <li>• 1 porte menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 porte USB 2.0;</li> <li>• 1 porte Console (RJ-45 ose USB);</li> <li>• 1 slot i lire për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps (moduli nuk kërkohet te jete i përfshirë);</li> <li>• Kabllo stakimi te përfshire;</li> </ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 512 MB flash;</li> <li>• 2 GB SDRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 4 MB;</li> </ul>
<b>Throughput/Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura non-blocking, te ofroj switchim wire-speed;</li> <li>• 180 Mpps throughput;</li> <li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 280 Gbps;</li> <li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li> <li>• Tabela e adresave MAC: 32K;</li> <li>• Vonesa me e vogël se 5 µs ne portat 1 ose 10 Gbps;</li> <li>• Lista kontroll aksesi: ACL ne 3K hyrëse(ingress) dhe 1K dalëse(egress);</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësire për 2 blloqe ushqimi;</li> <li>• Te jete i pajisur me një bllok ushqimi DC -48 VDC;</li> </ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri ne tete pajise ne një stack duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme qe lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• In service software upgrade;</li> <li>• Teknologji te avancuara nga ku te përfshihen standardet e industrisë për OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i standardit IEEE 802.1Q VLAN, 4094 ID;</li> <li>• Standardi IEEE 802.1ad QinQ ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE qe lejon grupimin dhe shfrytëzimin me te mire te linjave për te rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> </ul>



	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me ane te protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L3</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire(media);</li> <li>• Suport për rutim ne IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim ne IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Te ofroje ndërfaqe Loopback te adresueshme;</li> <li>• Standardet për tunelim te IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim ne Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP te duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelim GRE per VPN qe mundëson tunelim te Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<b>Karakteristika te avancuara për rrjetin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te ofroje MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS);</li> <li>• Equal-Cost Multipath (ECMP);</li> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll me te mire ne shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) qe suportojne filtrime trafiku duke u bazuar ne informacionet nga shtresa L2 deri ne L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, ne VLAN dhe ne porte;</li> <li>• ACL ne hardware me TCAM;</li> <li>• IEEE 802.1X sipas standardeve te industrisë ne bashkëpunim me Radius Server;</li> <li>• Menaxhim me SSHv2, HTTPS, SNMPv3 dhe me server qendror te tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Autentikim bazuar ne adresat MAC me Radius Server;</li> <li>• Kontroll aksesi bazuar ne identitetin e përdoruesit duke aplikuar ACL specifike ose VLAN ne nivel përdoruesi;</li> <li>• Port security, Port isolation, IP/IPv6 source guard;</li> <li>• Mbrojte nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP/DHCPv6 snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>
<b>QoS</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Te suportoj funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Te suportoj standarde: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Te ofroje limitim te trafikut te tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast te panjohur;</li> </ul>
<b>Menaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim ne distance ne CLI me SSH, VLAN menaxhimi, ruajtje logesh;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për të pasur 2 imazhe të sistemit të operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan në disa versione file-të e konfigurimit që lejon kthimin e pajisjes në një gjendje të caktuar;</li> <li>• Port mirroring dhe aftësi për të përzgjedhur në baze ACL trafikun hyrës/dalës nga një portë ose VLAN dhe të pasqyrojë atë në një portë lokale ose remote.</li> <li>• SNMP v1, v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licencimi</b>	Pajisja Switch do të jetë e licencuar për të gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius Lagështira relative e operimit: 15% to 90%, pa kondensim
<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim të pajisjes në ditën vijuese të punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit të përfshira

### Switch në nyjat dytësore (14 cope)

Këto pajisje do të mbledhin trafikun në Layer 2 nga sensorët dhe nënstationet pranë tyre dhe me pas në varësi të VPN ku bën pjesë do ta rrugëzojnë këtë trafik drejt qendrës.

<b>Switch Multi layer</b>	
<b>Forma fizike</b>	Rack mounted, 1 rack unit, thellësia jo më shumë se 40 cm aksesoret e përfshira.
<b>Porta/Ndërfaqet</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Minimumi 24 porta RJ45 (10/100/1000 Base-T);</li> <li>• 4 porta 10Gb që suportojnë transceivera SFP/SFP+;</li> <li>• Të paktën 8 porta me support për MACsec;</li> <li>• 1 portë menaxhimi RJ-45;</li> <li>• 1 portë USB 2.0;</li> <li>• 1 portë Console (RJ-45 ose USB);</li> <li>• 1 slot i lirë për modul opsional për shtim portash 10/40 Gbps (moduli nuk kërkohet të jetë i përfshirë);</li> </ul>
<b>Memoria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• 512 MB flash;</li> <li>• 2 GB SDRAM;</li> <li>• Madhësia e Packet buffer: 4 MB;</li> </ul>
<b>Throughput/Performanca</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Arkitektura non-blocking, të ofroj switchim wire-speed;</li> <li>• 160 Mpps throughput;</li> <li>• Kapacitet për Switchim/Rutim: 220 Gbps;</li> <li>• Tabela e rutimit: 32K (IPv4), 16K (IPv6);</li> <li>• Tabela e adresave MAC: 32K;</li> <li>• Vonesa më e vogël se 5 µs në portat 1 ose 10 Gbps;</li> <li>• Lista kontroll aksesit: ACL në 3K hyrës (ingress) dhe 1K dalës (egress);</li> </ul>
<b>Power</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Hapësirë për 2 blloqe ushqimi;</li> <li>• Të jetë i pajisur me një bllok ushqimi DC -48 VDC;</li> </ul>
<b>Disponueshmeria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji stacking dhe virtualizim duke bashkuar deri në tetë pajisje në një stack duke lejuar menaxhimin dhe konfigurimin si një pajisje e vetme që lehtëson implementimin dhe mirëmbajtjen;</li> <li>• In service software upgrade;</li> </ul>

	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Teknologji te avancuara nga ku te përfshihen standardet e industrisë për OAM, BFD, ECMP, VRRP;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L2</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Implementimi i standardit IEEE 802.1Q VLAN, 4094 ID;</li> <li>• Standardi IEEE 802.1ad QinQ ;</li> <li>• Bashkim portash 10GbE qe lejon grupimin dhe shfrytëzimin me te mire te linjave për te rritur sasinë e transmetimit;</li> <li>• Link Aggregation Control Protocol (LACP - IEEE 802.3ad);</li> <li>• Spanning Tree - MSTP, RSTP;</li> <li>• Minimumi 50 Instanca MSTP;</li> <li>• Kontroll mbi trafikun Multicast me ane te protokolleve Internet Group Management Protocol (IGMP v1,v2,v3) dhe Multicast Listener Discovery (MLD) snooping;</li> <li>• Voice VLAN, Multicast VLAN;</li> <li>• LLDP, LLDP-MED;</li> </ul>
<b>Karakteristikat e shtresës L3</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Switchim dhe ACL me shpejtësi wire(media);</li> <li>• Suport për rutim ne IPv4 sipas standardeve: Static routing, RIP, OSPF dhe BGP;</li> <li>• Suport për rutim ne IPv6 sipas standardeve: Static routing, RIPng, OSPFv3 dhe BGP4+;</li> <li>• Te ofroje ndërfaqe Loopback te adresueshme</li> <li>• Standardet për tunelim te IPv6 mbi IPv4;</li> <li>• Rutim ne Multicast (IPv4, IPv6): PIM-SM, PIM-DM, PIM-SSM;</li> <li>• Address Resolution Protocol (ARP): static, ARP proxy, Gratuitous ARP për detektimin e adresave IP te duplikuara;</li> <li>• DHCP Server, Relay;</li> <li>• Tunelim GRE per VPN qe mundëson tunelim te Layer2 mbi Layer3;</li> </ul>
<b>Karakteristika te avancuara për rrjetin</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Te ofroje MPLS me MPLS VPN dhe MPLS TE;</li> <li>• Virtual Private LAN Service (VPLS)</li> <li>• Equal-Cost Multipath (ECMP);</li> <li>• Rutim Policy-based;</li> <li>• Route maps për kontroll me te mire ne shpërndarjen e rutimeve;</li> </ul>
<b>Siguria</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Lista kontroll aksesi (ACLs) qe suportojne filtrime trafiku duke u bazuar ne informacionet nga shtresa L2 deri ne L4;</li> <li>• Suport për ACL globale, ne VLAN dhe ne porte;</li> <li>• ACL ne hardware me TCAM;</li> <li>• IEEE 802.1X sipas standardeve te industrisë ne bashkëpunim me Radius Server;</li> <li>• Menaxhim me SSHv2, HTTPS, SNMPv3 dhe me server qendror te tipit RADIUS dhe TACACS;</li> <li>• Autentikim bazuar ne adresat MAC me Radius Server;</li> <li>• Kontroll aksesi bazuar ne identitetin e përdoruesit duke aplikuar ACL specifike ose VLAN ne nivel përdoruesi;</li> <li>• Port security, Port isolation, IP/IPv6 source guard;</li> <li>• Mbrojte nga ARP attack me Dynamic ARP dhe DHCP/DHCPv6 snooping;</li> <li>• Unicast Reverse Path Forwarding;</li> </ul>

<b>QoS</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Mundësi për klasifikimin e trafikut bazuar ne: ACLs (access control lists), përparësitë e diktuar nga IEEE 802.1p dhe DSCP/Type of Service (ToS);</li> <li>• Te suportoj funksionet: remark, redirect, mirror dhe filter;</li> <li>• Te suportojte standarde: SP (Strict Priority Queuing), WFQ (Weighted Fair Queuing), WRED (Weighted Random Early Detection), WDRR (Weighted Deficit Round Robin);</li> <li>• Te ofroje limitim te trafikut te tipit storm nga Broadcast, Multicast dhe Unicast te panjohur.</li> </ul>
<b>Menaxhimi</b>	<ul style="list-style-type: none"> <li>• Konfigurim ne distance ne CLI me SSH, VLAN menaxhimi, ruajtje logesh;</li> <li>• Mundësi për te pasur 2 imazhe te sistemit te operimit, një primar dhe një sekondar (për backup);</li> <li>• Ruan ne disa versione filete e konfigurimit qe lejon kthimin e pajisjes ne një gjendje te caktuara;</li> <li>• Port mirroring dhe aftësi për te përzgjedhur ne baze ACL trafikun hyrës/dalës nga një porte ose VLAN dhe te pasqyroje atë ne një porte lokale ose remote;</li> <li>• SNMP v1, v2c and v3; NTPv3;</li> </ul>
<b>Licencimi</b>	Pajisja Switch do te jete e licencuar për te gjitha karakteristikat dhe kapacitetet me sipër.
<b>Karakteristikat mjedisore</b>	Temperatura e operimit: 0 – 45 grade Celsius; Lagështira relative e operimit: 15% to 90%, pa kondensim ;
<b>Garancia</b>	1 vit suport nga prodhuesi me dërgim te pajisjes ne ditën vijuese te punës (NBD) si dhe përditësimet e softuerit te përfshira.

### **Sistemi i monitorimit dhe menaxhimit të pajisjeve të rrjetit**

Zgjidhja e ofruar të bazohet në modelet dhe praktikat e ITIL.

Të ofrojë menaxhim të burimeve për të lejuar administrimin e pajisjeve nga prodhues të ndryshëm nëpërmjet një portali të vetëm. Administratorët mund të monitorojnë ‘shëndetin’ e pajisjes nëpërmjet detajeve të statusit së saj, duke zbuluar të dhëna në kohë reale, informacione përmbledhëse, testimet të komunikimit, etj.

Të ofrojë menaxhim të aseteve të rrjetit për të gjurmuar në çdo kohë asetet dhe ndryshimet në to.

Të mundësojë menaxhimin e gabimeve dhe defekteve në kohë reale. Integrimi i sistemit të menaxhimit të rrjetit të defekteve, performancës, auditimit, sigurisë, konfigurimeve zvogëlon kohën dhe përpjekjet e për të menaxhuar infrastruktura rrjeti komplekse.

Të ofrojë mundësinë e zgjerimit të menaxhimit të infrastrukturës së institucionit në mënyrë të shkallëzuar dhe pa shkaktuar ndërprerje për të implementuar teknologjitë e reja në të njëjtën kohë.

Të suportojë dhe menaxhojë pajisje nga prodhues të ndryshëm, si Cisco, HPE, Fortinet, etj. Të jetë kompatibël me sisteme operative si Microsoft Windows dhe Linux. Të suportojë bazat e të dhënave si Oracle, Microsoft SQL Server, MySQL, etj.

Të mundësojë përdorimin e një paneli të qendëruar për menaxhimin nga pika në pikë të procesit të shërbimeve TLC.

Të mundësojë menaxhimin e konfigurimeve dhe ndryshimeve të tyre. Administratorët dhe operatorët mund të monitorojnë, të instalojnë programe në pajisje, të aksesojnë modele konfigurimi, të përdorin libraritë e programeve, të fshijnë konfigurimet në pajisje për t’i zhvendosur në pozicione të reja, të bëjnë backup të konfigurimeve, etj.

